



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot.
Org. Unit	Prot. No.
Nr. i Faqeve Bc Stranica	Data Datum
No. Pages	Date
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.02.2024
REFERENC-Ë:	4734/23- ARPL
PËR/ZA/TO:	„Bazeli Sport“ SH.P.K., Elezaj- Kaçanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI- Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së Z. Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Sylejmon Latifi - Zyrtar përgjegjës për akte ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 4734 /23, dt.18.08.2023, për shkarkim, Qendra rekreative sportive me pishinë „Bazeli Sport“ SH.P.K., Elezaj- Kaçanik dhe ka vendosur si në Vendimin për Leje Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Datë: 15.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjenive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „Bazeli Sport“ SH.P.K., Elezaj- Kaçanik, me Nr. prot. 4734/23, dt.18.08.2023 për **LEJE UJORE** për shkarkim të ujërave nga Qendra rekreative sportive me pishinë, për palën në pikën me koordinata:

X =7515154 ; Y =4684122 ; sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko - investiv për kompleksin e objekteve nën kushtet vijuese:
2. Kjo Leje Ujore i referohet ekskluzivisht shkarkimit të ujërave të ndotura nga Qendra rekreative sportive me pishinë „Bazeli Sport“ SH.P.K., Elezaj-Kaçanik;
3. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;

Faqe 2 nga 4



4. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues kualitativ të recipientit (temperatura, ph, SHBO₅, SHKO, sasia materieve të suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe specifikat e recipientit;
5. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
6. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe t'i kompensoj;
7. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit duke përfshirë edhe mjedisin pritës. Rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL;
8. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ 06/2021 për "Strukturën e pagesave të ujit në fuqi";
9. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
10. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtari përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborati dhe dokumentacioni tekniko- investiv për shkarkimin e ujërave nga Qendra Rekreative Sportive me Pishinë "Bazeli Sport" SH.P.K, Elezaj-Kaçanik"; marrëveshje bashkëpunimi me "Alpha Zero1" SH.P.K, për kompletimin e dokumentacionit; Çertifikata e Regjistrimit te Biznesit -ARBK - "Bazeli Sport" SH.P.K; Çertifikata e Regjistrimit te Biznesit të kompanisë hartuese-ARBK - "Alpha Zero1"SH.P.K; Pëlqim Mjedisorë nga MMPH nr. 940-2/17 dt. 06.04.2017; Leje ndërtimore me nr. 350-5094/2017, të dt. 22.09.2017; Fatura e tatimit në pronë; Çertifikatë e pronësisë; Kopja e Planit; Koordinatat, Diploma e Veton Elshanit, Bachelor i Ndërtimtarisë; Plani i Situacionit i punuar nga person i licencuar i lëmise përkatëse, me nr. licence 17, Zekirja Elezi, Situacioni i terrenit 1:1000; CD.



Faturat e pagesave për Kushte Ujore , Pëlqim Ujor dhe Leje Ujore.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe dokumentacionin shtesë me nr. 4734 – 2/23, të dt. 09.02.2024, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 4734-2/23 Datë: 13.02.2024

Prishtinë

T'i dërgohet :

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së
- Inspektoratit të MMPHI-së
- Komunës Kaçanik;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Izedin BYTYQI